



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/73

Datë: 07.07.2009


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, dhe duke u bazuar në rekomandimet e Këshillit Kombëtar të Cilësisë të Agjencionit Kosovar për Akreditim, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 07 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. Asnjë Bartës Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) në Republikën e Kosovës, aktualisht nuk mund të bartë emrin Universitet, të jep tituj akademik për mësimdhënësit apo të ofrojë studime të Doktoratës.
2. Çdo BPrAL në Republikën e Kosovës, në përputhje me rekomandimet e Këshillit Kombëtar të Cilësisë (KKC) të Agjencionit Kosovar për Akreditim (AKA), i ka plotësuar standardet dhe kriteret e parapara me Ligjin mbi Arsimin e Lartë dhe Udhëzimet përkatëse administrative, merr emrin "Kolegj".
3. Në përputhje me rekomandimet e KKC të AKA, emrin "Kolegj" e bartin këta BPrAL: "AAB-Riinvest", "Fama", "UBT", "ISMI", "Victory" dhe "Iliria".
4. Çdo BPrAL i cili sipas rekomandimeve të KKC të AKA që i ka përmbushur pjesërisht kriteret dhe standardet për akreditim dhe si i tillë akreditohet me kusht, mund ta bartë emrin "Institut".
5. Në përputhje me rekomandimet e KKC të AKA, emrin "Institut" e bartin këta BPrAL: "Universum", "Pjetër Budi" dhe "Biznesi".
6. Në përputhje me rekomandimet e KKC të AKA dhe Udhëzimin përkatës administrativ, emrin "Shkolla e Lartë Profesionale" e marrin këta BPrAL: "Tempulli", "Evolucion" dhe "Design Factory".

7. Akreditohet si "Kolegj" BPrAL "AAB-Rinvest" me këto programe studimi: Ekonomiks Biznesi (BSc); Banka, Financa dhe Kontabilitet (BSc dhe MSc); Menaxhment dhe Informatikë (BSc); Marketing dhe Administrim Biznesi (BSc); Zhvillim i Financave (MSc); Tregjet Financiare dhe Bankat (MSc); Shkenca Kompjuterike-Inxhinieri Softverike (BSc); Juridik i Përgjithshëm (BSc); Komunikim Masiv- Gazetari (BSc); Komunikim Masiv- Produksion (BSc); Kulturë Fizike dhe Sport (BSc).
8. Akreditohet dhe licencohet si "Kolegj" BPrAL "FAMA" me këto programe studimi: Menaxhment (BA); Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA); Juridik (BA); Kriminalistikë (BA); Shkenca Politike dhe Administrim Publik (BA).
9. Akreditohet dhe licencohet si "Kolegj" BPrAL "UBT" me këto programe studimi: Menaxhment Biznes dhe Ekonomi (BSc); Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri (BSc); Menaxhim i Mekatronikës (BSc);
10. Akreditohet si "Kolegj" BPrAL "Victory" me këto programe studimi: Ekonomi Biznesi-Tregti e Jashtme (BSc); Politikë Ndërkombëtare dhe Diplomaci (BSc),
11. Akreditohet dhe licencohet si "Kolegj" BPrAL "Instituti për Studime të Menaxhmentit Internacional - ISMI" me këto programe studimi: Menaxhment Gjeneral Internacional (Ba); Menaxhimi i Kontabilitetit dhe Financave Internacionale (BSc).
12. Akreditohet dhe licencohet si "Kolegj" BPrAL "Iliria" me këto programe studimi: Ekonomiks Banka dhe Kontabilitet (BSc); Juridik i Përgjithshëm (BSc); Edukim sportiv (BA); Radiologji Diagnostike (Ba); Menaxhment dhe Informatikë (BSc); Informatikë e Aplikuar (BSc).
13. Akreditohet dhe licencohet si "Institut" BPrAL "Biznesi" me këto programe studimi: Banka dhe Financa në Biznes (Ba), Menaxhim i Emergjencave (si program profesional i nivelit 6 sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve - EQF).
14. Akreditohet dhe licencohet si "Institut" BPrAL "Universum" me këtë program studimi: Biznes dhe Menaxhment (BA).
15. Akreditohet dhe licencohet si "Institut" BPrAL "Pjetër Budi" me këto programe studimi: Dogana dhe Shpedicion (Ba); Turizëm dhe Hotelieri (Ba).
16. Akreditohet dhe licencohet si "Shkollë e Lartë Profesionale" BPrAL "Evolucion" me këto programe studimi: Dizajn Mode dhe Kostumografi (si program profesional i nivelit 6 sipas EQF); Dizajn Enterieri dhe Skenografi (si program profesional i nivelit 6 sipas EQF); Dizajn Komunikimi (si program profesional i nivelit 6 sipas EQF); Pikturë (si program profesional i nivelit 6 sipas EQF).

17. Akreditohet dhe licencohet si "Shkollë e lartë Profesionale" BPrAL " Design Factory" me këtë program studimi: Dizajn Mode - Modelizëm dhe Stilizëm (si program profesional i nivelit 5 sipas EQF).
18. Akreditohet dhe licencohet si "Shkollë e Lartë Profesionale" BPrAL "Tempulli" me këto programe studimi: Trafik Rrugor dhe Transport (si programe profesionale të nivelit 6, 5 dhe 4 sipas EQF); Komunikim Postar dhe Telekomunikacion (si programe profesionale të nivelit 6, 5 dhe 4 sipas EQF); Trafik Hekurudhor dhe Transport (si programe profesionale të nivelit 6, 5 dhe 4 sipas EQF).
19. Çdo BPrAL i cili bartë emrin "Kolegj" mund të regjistrojë deri në 500 studentë të rinj në vitin akademik 2009/2010 dhe çdo BPrAL që bartë emrin "Institut" mund të regjistrojë deri në 250 studentë të rinj në vitin akademik 2009/2010.
20. Çdo BPrAL i cili në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Shkolla të Larta Profesionale dhe rekomandimet e KKC të AKA akreditohet si Shkollë e Lartë profesionale, mund të regjistrojë numër të pakufizuar të studentëve të rinj.
21. Çdo BPrAL i cili bartë emrin "Kolegj" mund të regjistrojë deri në 50 studentë të rinj në programet master.
22. BPrAL-ët e akredituar si Shkolla të Larta Profesionale mund të pranojnë studentë në nivelin 4 sipas Kornizës së Kualifikimeve edhe pa provimin e pjekurisë-matura shtetërore.
23. BPrAL "Dardania" është aktualisht në procesin e akreditimit si "Kolegj".
24. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të lëshojë licencat në përputhje me këtë vendim.
25. Akreditimi dhe licenca kanë fuqi ligjore vetëm për vitin akademik 2009/2010.
26. Obligohen AKA dhe MASHT që në rast të moszbatimit të kushteve të akreditimit dhe licencës nga ana e BPrAL, t'ia tërheqin akreditimin dhe licencën e dhënë.
27. Ngarkohen MASHT dhe AKA që të monitorojnë përmbushjen e rekomandimeve në rastet e akreditimit me kusht.
28. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë